




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 34, datë 17.3.2023

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:


1. Struktura e Agjencisë së Prokurimit Publik të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë së Prokurimit Publik të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Prokurimit Publik të jetë, gjithsej, 48 veta.
4. Urdhri nr.149, datë 28.12.2021, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

STRUKTURA E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK



SKEMA 2

ORGANIKA E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1 DREJTOR I PËRGJITHSHËM	I-b	1
SEKRETAR		1
2 DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË KONTRATAVE		10
DREJTOR	II-b	1
2.1 SEKTORI I KOORDINIMIT		5
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	4
2.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KONTRATAVE		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-a/1	3
3 DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE		14
DREJTOR	II-b	1

NR.PROT. 677/3
DATË 20. 3. 2023

KRYEMINISTRISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

